

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7943
E martë, 3 dhjetor 2024
Çmimi 0.50 €

Kumanova regjistron
disa zjarrvënie që
dyskohet të jenë kryer
qëllimshëm | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË HËNËN SEANCË PLENARE
PËR PUNËN KATËRVJEÇARE TË QEVERISË KURTI

KURTI KRENOHET ME QEVERISJEN, OPOZITA THOTË SE E KA SAKATUAR KOSOVËN NË TË GJITHA NIVELET

| FAQE 4-5



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në seancën parlamentare të thirrur nga AAK-ja për qeverisjen katërvjeçare, ka thënë se është

krenar për katër vjetët e qeverisjes së tij, e cila, sipas Kurtit, ka shënuar përplot të arritura. Ndërkaq deputetët e opozitës kanë theksuar se Kurti

e ka sakatuar Kosovën në të gjitha nivelet, madje duke rrezikuar raportet edhe me ndërkombëtarët, veçanërisht me ShBA-në

HOVENIERI PËR SULMIN
NË IBËR-LEPENC:
HERËT TË DIHET
FAJTORI, NUK MUND TË
PËRJASHTOHET ASNJË
GRUP APO SHTET | F. 3




ZGJEDHJET E 9
SHKURTIT, KOZ-ja:
SUBJEKTET
POLITIKE ENDE
NUK KANË
DORËZUAR LISTAT
E KANDIDATËVE | F. 5



OPINION

LUFTA HIBRIDE NË PRAG TË
ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE
NË KOSOVË | F. 5

Shkruan:
Bekim ÇOLLAKU



AKTUALE



BIDENI FAL DJALIN HUNTER,
REPUBLICANËT E KRITIKOJNË | F. 2

GAZETARI DRIN EUPI I BASHKOHET
PDK-SË, GARON EDHE PËR DEPUTET

| F. 7

EKONOMI



RRUGËT QË MBETEN NË NDËRTIM
E SIPËR | F. 8

ISH-GUVERNATORI I BQK-së:
KOSOVA OFRON SHUMË MUNDËSI
PËR BIZNESET AMERIKANE | F. 8

SPORT



'YLLI I JAVËS' NË SUPERLIGË, MANAJ:
SYNOJMË EDHE TRI FITORE | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni fal djalin Hunter, republikanët e kritikojnë

WASHINGTON, 2 DHJETOR - Presidenti amerikan Joe Biden ka bërë me dije se e ka falur djalin e vet, Hunter Biden, ndonëse kishte premtuar se do të rrinte larg procedurave ligjore që rëndonin kundër djalit të tij. Hunter Biden është deklaruar i pafajshëm në akuzat për mashtrime me taksa dhe është dënuar për një rast që lidhet me armëmbajtje. "Sot e kam nënshkruar faljen për djalin tim Hunter. Prej ditës kur e kam marrë detyrën kam thënë se nuk do të përzihem në vendimmarrjen e Departamentit Amerikan të Drejtësisë dhe e kam mbajtur fjalën edhe teksa e kam parë djalin tim duke u gjykuar

padrejtësisht dhe në mënyrë selektive", ka thënë presidenti përmes një deklaratë. Shtëpia e Bardhë ka thënë vazhdimisht se Bideni nuk do ta falë Hunterin, i cili i është nënshtruar një periudhe rehabilitimi nga përdorimi i drogave. "Asnjë njeri i arsyeshëm që analizon faktet për rastin e Hunterit nuk mund të arrijë në përfundim tjetër përveçse Hunter është veçuar sepse ka qenë djali im", ka thënë Bideni përmes një deklaratë të lëshuar pak para nisjes në një udhëtim në Afrikë. Vendimi për falje vlen për të gjitha veprimet që mund të jenë kryer në periudhën 1 janar 2014 - 1 dhjetor 2024. Hunter Biden ishte paraparë të



përballej me dënimet këtë muaj. "E kam pranuar dhe kam marrë përgjegjësi për gabimet e mia gjatë ditëve më të rënda të varësisë - gabime që janë

shfrytëzuar për të më nënvlerësuar dhe për të më turpëruar mua dhe familjen time për shkaqe politike", ka thënë Hunter Biden përmes një

deklaratë, duke siguruar të gjithë se është i pastër nga çdo drogë për më shumë se pesë vjet. Republikanët e kanë kritikuar vendimin e presidentit. Presidenti i zgjedhur amerikan Donald Trump e ka quajtur vendimin abuzim dhe ka pyetur nëse në falje janë përfshirë edhe personat e burgosur për sulmin në Kongresin amerikan më 6 janar të vitit 2021, pasi Trumpi pati pretenduar se i ka fituar zgjedhjet e vitit 2020. Bideni, në anën tjetër, ka thënë se vendimin për falje e ka marrë këtë fundjavë. "Shpresoj që amerikanët do ta kuptojnë pse një baba dhe një president mund të marrë një vendim të tillë", ka thënë ai.

Social-Demokratët janë në prag të fitores në zgjedhjet parlamentare rumune



BUKURESHI, 2 DHJETOR - Partia Social-Demokrate e Rumanisë, aktualisht në pushtet, është në prag të shënimit të fitores në zgjedhjet parlamentare, për të nisur më parë bisedimet për të formuar një koalicion proterëndimor. Votimet e 1 dhjetorit janë mbajtur një javë pas zgjedhjeve të kontestuara presidenciale në këtë shtet, në të cilat një kandidat pro-rus, i së djathtës ekstreme, ka arritur të kalojë në raundin e dytë zgjedhor. Gjykata Kushtetuese e këtij vendi ka urdhëruar rinumërimin e votave të raundit të parë të zgjedhjeve

presidenciale. Banorët e Rumanisë - vend anëtar i Bashkimit Evropian dhe NATO-s - janë në pritje të rezultateve përfundimtare, pasi ato preliminare tregojnë se Partia Social-Demokrate (PSD) ka më shumë vota sesa partia ultranacionaliste e ekstremit të djathtë, Aleanca për Unitet të Rumunëve (AUR). Pas numërimit të 99.3 për qind të votave, PSD ka siguruar 22.7 për qind të votave, ndërsa AUR ka siguruar 18.2 për qind. Partia që fiton më së shumti vota do të ketë të drejtën e nominimit të kandidatit për kryeministër.

Nëse asnjëra parti - siç edhe pritet - nuk do ta fitojë shumicën parlamentare, atëherë do të nisnin negociatat jo fort të lehta për formim të qeverisë dhe gjithçka do të varet edhe nga rezultati i raundit të dytë të zgjedhjeve presidenciale që do të mbahen javën tjetër. Dalja në zgjedhje ka qenë 52.36 për qind, që do të thotë se 9.43 për qind e votuesve kanë shfrytëzuar të drejtën e votës - shifra më e lartë në 12 vitet e fundit. Në këtë proces zgjedhor nuk është raportuar për ndonjë parregullsi të madhe.

Rreziku nga mbetjet plastike, dështojnë negociatat për arritjen e një marrëveshje

BUSAN, 2 DHJETOR - Vendet e botës që po negocionin prej një jave në Korenë e Jugut për një traktat global për t'o frenuar mbetjet plastike nuk arritën një marrëveshje të hënën, pasi më shumë se 100 vende donin ta kufizonin prodhimin e objekteve plastike, ndërsa një pjesë e vogël e shteteve prodhuese të naftës ishin të gatshëm ta trajtonin vetëm problemin e mbetjeve plastike. Takimi i pestë i Komitetit Negociator Ndërqeveritar të OKB-së (INC-5), që synonte miratimin e një traktati global ligjërish të detyrueshëm në Busan të Koresë së Jugut, ishte parashikuar të ishte i fundit. Por vendet kishin qëndrime të ndryshme lidhur me objektivin bazë të një traktati dhe arritën vetëm të bien dakord që ta shtyjnë afatin për vendimet

kryesore dhe t'i rifillojnë bisedimet, të quajtura INC 5.2, në një datë të mëvonshme. "Është e qartë se ka ende mosmarrëveshje", tha Inger Andersen, drejtoreshë ekzekutive e Programit të Mjedisit të OKB-së. Çështjet më delikate përfshinin kufizimin e prodhimit të plastikës, menaxhimin e produkteve plastike dhe kimikateve të lidhura me to, si dhe ndihmën financiare për vendet në zhvillim në mënyrë që ato ta zbatonin traktatin. Një variant i propozuar nga Panamaja, i mbështetur nga më shumë se 100 vende, parashikonte një plan për një objektiv global të reduktimit të prodhimit të plastikës, ndërsa një propozim tjetër nuk përfshinte vendosjen e një kufizimi të tillë të prodhimit.



Mospërputhjet ishin të dukshme në një dokument të lëshuar të dielën nga drejtuesi i takimit, Luis Vayas Valdivieso, i cili mund ta përbëjë bazën e një traktati, por që përfshinte alternativa të ndryshme për çështjet më të ndjeshme. "Një traktat që parashikon vetëm masa

vullnetare nuk do të ishte i pranueshëm", tha Juliet Kabera, drejtoreshë e përgjithshme e Autoritetit të Menaxhimit të Mjedisit të Ruandës. "Është koha që ta marrim seriozisht dhe të negociojmë një traktat që është i përshtatshëm për objektivin dhe nuk është i destinuar të dështojë

që në pikënisje", tha ai. Një numër i vogël i vendeve që prodhojnë materiale petrokimike, si Arabia Saudite, kanë kundërshtuar fuqishëm përpjekjet për ta shkurtuar prodhimin e plastikës dhe janë përpjekur të përdorin taktika procedurale për t'i zvarritur negociatat. "Nuk pati konsensus në asnjë moment", tha delegati i Arabisë Saudite Abdulrahman Al Gwaiz. "Ka disa lloj materiale që në një mënyrë ose një tjetër arrijnë të përfshihen (në dokument) pavarësisht këmbënguljes sonë të vazhdueshme se ato nuk janë brenda objektivit". Kina, Shtetet e Bashkuara, India, Koreja e Jugut dhe Arabia Saudite ishin vendet kryesore të prodhimit të polimerit në vitin 2023, sipas firmës konsulente Eunomia.

Hovenieri për sulmin në Ibër-Lepenc: Herët të dihet fajtori, nuk mund të përjashtohet asnjë grup apo shtet

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të hënën se vendi i tij dënon në nivelin më të lartë sulmin "e tmerrshëm" që është kryer në kanalën e Ibër-Lepencit më 29 nëntor në Zubin Potok dhe që, ndonëse është herët të dihet fajtori, në këtë fazë "nuk mund të përjashtohet asnjë grup apo shtet". Ai i ka bërë këto deklarata pas një takimi me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, i cili e ka ftuar korin diplomatik në Kosovë për t'i njoftuar për më të rejtat lidhur me këtë sulm që Kosova e konsideron terrorist dhe e fajëson Serbinë. Serbia, në anën tjetër, i mohon të gjitha akuzat dhe ka thënë se po kryen hetimet e veta për këtë rast. "Mendojmë që është e rëndësishme të bëhet një hetim gjithëpërfshirës dhe i besueshëm për t'i identifikuar përgjegjësit dhe për t'i vënë përpara drejtësisë. Në këtë pikë nuk mund të themi se kush është përgjegjës dhe, gjithashtu, nuk jemi në pozicion për të përjashtuar asnjë grup, shtet apo diçka tjetër. Është shumë herët", tha ai, duke theksuar se sapo të përcaktohen kryesit e sulmit, Shtetet e Bashkuara do të punojnë me autoritetet e Kosovës për t'u siguruar që ata të mbahen përgjegjës. "Ky është një zotim nga Shtetet e Bashkuara. Unë besoj se është një zotim edhe nga partnerët e tjerë meqë ne të gjithë duam t'i shohim autorët e këtij sulmi të tmerrshëm kriminal të mbahen përgjegjës", tha ai. I dërguari i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, ka thënë se zyrtarët më të lartë të BE-së e kanë

bërë të qartë qëndrimin e tyre për këtë rast, si referencë për deklaratën e bllokut evropian, i cili e ka konsideruar sulmin si terrorist dhe sabotues. Sulmi ka ndodhur në fshatin Varragë të komunës së Zubin Potokut - komunë me shumicë serbe në veri të vendit. Policia e Kosovës ka thënë se sulmi është kryer me lëndë shpërthyesë deri në 20 kilogramë. Kanali Ibër-Lepenc furnizon me ujë nga Liqeni i Ujmanit gjithë veriun e Kosovës, rajonet e Mitrovicës, Prishtinën me rrethinë, si dhe Korporatën Energjetike të Kosovës për ftohjen e termoelektraneve të saj. Autoritetet e Kosovës kanë ndaluar fillimisht tetë të dyshuar lidhur me këtë sulm dhe kanë kryer bastisje në pjesën veriore të vendit. Gjykata Themelore në Prishtinë ka bërë me dije të dielën se të pandehurit D. V. ia ka caktuar masën e paraburgimit prej 1 muaji nën dyshimet se ka kryer veprën penale rrezikim i rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike. Sulmi është dënuar ashpër nga faktori ndërkombëtar.

Kurti për sulmin në veri: Sulmi është kryer nga grupe të mbështetura e të dirigjuara nga Serbia

Me ftesë të tij, kryeministri Albin Kurti, bashkë me zëvendëskryeministrin e parë për Integritim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, ka mirëpritur të hënën në takim ambasadorët, të ngarkuarit me punë, shefat e misioneve diplomatike dhe zëvendësambasadorët e akredituar



në Kosovë, për t'i informuar dhe diskutuar mbi sulmin kinetik të mbrëmjes së 29 nëntorit në Varagë të Zubin Potokut, në infrastrukturë kritike, në kanalën kryesor të Ibër-Lepencit. Përgjatë takimit kryeministri Kurti theksoi se qëllimi i këtij sulmi ka qenë dëmtimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe furnizimit me ujë në pjesën më të madhe të vendit, duke qenë sulmi i tretë në 72 orë kundër Republikës sonë, pas atyre të 26 dhe 28 nëntorit në Stacionin Policor në Zveçan dhe në afërsi të objektit të kësaj komune. Kryeministri Kurti tha se një sulm të tillë të ngjashëm ndaj infrastrukturës kritike e kemi parë pak ditë më parë edhe kundër

infrastrukturës kritike të Ukrainës, e cila u sulmua nga raketat ruse. Shtoi se indikacionet tregojnë se sulmi është kryer nga grupe dhe persona profesionistë të mbështetur e të dirigjuar nga Serbia. Ai i informoi diplomatët e pranishëm se policia po i zhvillon hetimet, gjersa tashmë ka të arrestuar të dyshuar të ndërlidhur me sulmin e përgjegjës për ekzekutimin e tij, si dhe dëshmi dhe prova materiale, ndër to edhe armë, eksplozivë e uniforma dhe emblema të njëjësive ushtarake ruse. Kryeministri nënvizoi se kriminelët e terroristët do të përballen me drejtësinë, me fuqinë e ligjit të drejtë të Republikës demokratike dhe të pavarur të Kosovës.

Më e, foli edhe për rëndësinë e ekstradimitit dhe arrestimit të kryekriminelit dhe kryeterroristit Millan Radoičiq i cili vazhdon të jetë i lirë në Serbi, duke organizuar e planifikuar me mbështetjen e Beogradit zyrtar dhe presidentit Aleksandar Vučić, sulme në vazhdimësi ndaj Republikës së Kosovës. Serbia vazhdon t'i mbështesë grupet terroriste me armë, financa dhe logjistikë, që solli që pas sulmit në Banjskë të pasojnë edhe sulme të tjera, përfshirë edhe aktin e fundit terrorist në kanalën e Ibër-Lepencit. Gjithashtu, kryeministri shprehu falënderimin për të gjithë partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e tyre ndaj Republikës së Kosovës.





KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR TË HËNËN SEANCË PLENARE PËR PUNËN KATËRVJEÇARE TË QEVERISË KURTI

Kurti krenohet me qeverisjen, opozita thotë se e ka sakatuar Kosovën në të gjitha nivelet

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në seancën parlamentare të thirrur nga AAK-ja për qeverisjen katërvjeçare, ka thënë se është krenar për katër vjetet e qeverisjes së tij, e cila, sipas Kurtit, ka shënuar përplot të arritura. Ndërkaq deputetët e opozitës kanë theksuar se Kurti e ka sakatuar Kosovën në të gjitha nivelet, madje duke rrezikuar raportet edhe me ndërkombëtarët, veçanërisht me ShBA-në

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në seancën parlamentare të thirrur nga AAK-ja të hënën, ka thënë se është krenar për katër vjetet e qeverisjes së tij. "Qëndroj sot para jush me krenari dhe vetëbesim mbi këtë katërvjeçar të qeverisjes sonë që ka qenë me përplot të arritura dhe me më shumë sfida sesa që jemi mësuar. Histori ndryshimesh që prekin jetën e të gjithë qytetarëve dhe secilën kategori shoqërore", ka thënë Kurti para deputetëve të pozitës dhe të opozitës. Kryeministri u shpreh se në këto katër vjet të qeverisjes ekonomia ka shënuar rritjen më të madhe. "Kemi pasur

rritje ekonomike mesatarisht 6.36 % të bruto produktit vendor. E kemi ulur edhe borxhin publik në vetëm 17 % apo për çerekun më të vogël që e kemi gjetur. Papunësia ka rënë nga 25.8 % në 10.7 %. Sfidë që na ngelet në këtë aspekt është aktivizimi më i madh i grave. Ne e dimë që nuk mjafton vetëm të krijosh vende pune, por është e domosdoshme që sektori privat, që është bartësi kryesor i punësimit, të ketë rritje të aktivitetit dhe ta riinvestojnë fitimin", ka thënë Kurti, duke shtuar se si qeveri kanë bërë mbështetje për punësimin e 12 mijë grave. "Pagën minimale e kemi tash 350 euro, ndërkohë që e kemi gjetur 130 dhe 170 euro. Ka pasur diskriminim sipas

moshës. Ata që janë nën 35 vjeç e kanë pasur pagën minimale 130, kurse ata mbi 35 e kanë pasur 170 euro. Tash të gjithë e kanë 350 euro. Shpenzimet kapitale në vitin 2023 kanë qenë më të lartat në historinë e Kosovës së pavarur, 561 milionë euro. Gjatë nëntë muajve të këtij viti kemi rritje prej 23 % të shpenzimeve kapitale krahasuar me vitin paraprak", ka deklaruar Kurti. Kryeministri u shpreh se 14 mijë të rinj mes moshës 18-29 vjeç janë punësuar përmes platformës "Superpuna" dhe 51 % janë vajza e gra e 49 % djem. Ai ka folur edhe për mbylljen e strukturave paralele në veri. "Janë mbyllur shërbimet ilegale në komunat veriore, e kemi eliminuar

ndikimin e organizatave terroriste, por kjo nuk do të thotë që nuk ka elemente kriminale atje. Kemi shtruar rrugë edhe në komunat në veri, gjithnjë më shumë qytetarë serbë po bashkëpunojmë me institucionet e Kosovës", është shprehur Kurti. Ai ka thënë se e di që janë kritikuar që nuk ka njohje të reja, por ka theksuar se nuk e kanë premtuar këtë në fushatë. "Ne kemi premtuar punësim dhe drejtësi", është shprehur Kurti. Ndërkaq opozita ka drejtuar akuza për qeverisjen Kurti. Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se Kurti po e lë Kosovën pa projekte konkrete dhe me një situatë të rënduar ekonomike dhe sociale. "Kurti po e lë Kosovën pa asnjë projekt që e ka nisur dhe përfunduar. Emigrimi i popullsisë për arsye ekonomike është fenomeni më i dhimbshëm që ka prekur vendin në këto katër vjet", ka deklaruar Tahiri.

Ai shtoi se Kosova ka përjetuar përkeqësim të marrëdhënieve me ndërkombëtarët, duke përmendur stagnimin në raportet me ShBA-në dhe sanksionet nga BE-ja. "Vendin tonë po e lënë nën sanksione. Republika e Kosovës, përjashtimisht kontratat që i ka nënshkruar me BE-në para qershorit të vitit 2023. Prej qershorit të vitit 2023 BE-ja në Kosovë paguan paga vetëm për punëtorët e vet. Përdërisa Shqipërisë i janë ndarë 900 milionë euro deri në vitin 2025, fonde të para-anëtarësimit. Ne nga qershori i vitit 2023 e deri sot që po flasim të vetmet mjete që BE-ja i shpenzon në Kosovë janë pagat e stafit. Asgjë tjetër. Këtu e ka sjellë subjektivitetin ndërkombëtar kryeministri jonë. Më e dhimbshme se ky është raporti me Shtetet e Bashkuara të Amerikës", ka shtuar ai. Në anën tjetër, Tahiri ka theksuar se politika e jashtme ka dështuar gjatë qeverisjes së Kurtit. Krahas kësaj, ai tha se kreu qeveritar ka rrezikuar edhe raportet me Shtetet e

Zgjedhjet e 9 shkurtit, KQZ-ja: Subjektet politike ende nuk kanë dorëzuar listat e kandidatëve

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka nisur përgatitjet për zgjedhjet parlamentare të planifikuara për 9 shkurt 2025, por deri tani subjektet politike nuk kanë dorëzuar listat e kandidatëve për deputetë.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, në një prononcim për "Telegrafi"-n, njoftoi se asnjë aplikim nga partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur nuk është pranuar ende. Ai theksoi se afati për dorëzimin e kërkesave për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhje është deri më 11 dhjetor 2024. "Deri

më 11 dhjetor subjektet politike (partitë politike, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur) duhet të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesat e tyre për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës që do të mbahen më 9 shkurt 2025. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe subjektet politike duhet t'i dorëzojnë edhe listat e tyre me emrat e kandidatëve për deputetë. Kjo periudhë ka filluar më 1 shtator, por mund t'ju konfirmoj se deri më tani nuk kemi pranuar ndonjë aplikim nga ana e subjekteve politike", tha



zëdhënësi i KQZ-së, Elezi. I pyetur se pasi subjektet politike t'i dorëzojnë listat për

kandidatët për deputetë se a do ta bëjë KQZ-ja verifikimin e tyre, ai tha: "Këshilli Gjyqësor i

Kosovës është një prej institucioneve që KQZ-ja do të kërkojë verifikim të kandidatëve. Në nenin 30 të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, theksohet se kandidat nuk mund të jetë një person nëse 'është dënua në tri vitet e fundit me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale, me një ose më shumë vjet burgim efektiv'. Prandaj, me qëllim të zbatimit të këtij përcaktimi ligjor, do të kërkojmë nga KGJK-ja që ta verifikojë listën e kandidatëve nëse ndonjëri prej tyre nuk është në përputhje me këtë kufizim ligjor".



Bashkuara të Amerikës. "Tash e dy vjet kur kemi një stagnim të këtij bashkëpunimi dhe kur kemi një relacion të dëmtuar me ShBA-në, ne kemi mbërritur në një situatë kur s'kemi as anëtarësime në organizata ndërkombëtare. S'po flas për shoqata, pasi ato që i tha kryeministri s'kisha dashur t'i dëgjoj prej gojës së një kryeministri. S'je anëtarësuar në Interpol, UNESCO dhe të tjera", është shprehur ai.

Edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, ka kritikuar ashpër punën e

qeverisë Kurti, duke e cilësuar atë si të paafte dhe të dështuar në të gjitha fushat. "Kurtin nuk e kemi parë si kryeministër që sjell përmirësim, por më shumë si drejtor ndërmarrjesh e çerdhesh. Në ekonomi, shëndetësi dhe arsim, kjo qeveri ka dështuar plotësisht", ka thënë Gashi.

Ai ironizoi duke thënë se i vetmi sukses i qeverisë është hartimi dhe miratimi i doracakëve për edukimin seksual, ndërsa premtimet për zhvillim ekonomik, ndërtimin e spitaleve dhe përmirësimin e kushteve të punëtorëve nuk janë

realizuar. "Kjo qeveri mund të kualifikohet si e paafte dhe e dështuar, me shkelje të rënda kushtetuese. I vetmi sukses që ka pasur ka qenë hartimi dhe miratimi i doracakëve për edukimin seksual", ka thënë Gashi.

Gashi dështim të plotë e konsideroi edhe politikën e jashtme, derisa tha se aleatët përmes sanksioneve i kanë vënë damkën e turpit kësaj qeverie. "Fatkeqësisht bilanci i qeverisë aktuale në këtë fushë është dështim i plotë, asnjë njohje e re, asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare, duke përfshirë UNESCO-n, INTERPOL-in, EURPOL-in,

Këshillin e Evropës. Së treti sanksione nga BE-ja dhe ShBA-ja, aleatët tanë më të rëndësishëm, ia kanë vënë damkën kësaj qeverie, damkën e turpit, duke i vendosur sanksione", ka theksuar ai.

Deputetja e AAK-së, Time Kadrijaj, ka thënë se kryeministri Albin Kurti ka "treguar përralla" gjatë prezantimit të qeverisjes katërvjeçare të tij. Ajo e ka akuzuar qeverinë për skandale të shumta. "Kryeministri na tregoi përralla. Jemi ngj përralla, kryeministër. U dashtë sot me dalë këtu me tregu çka ke bo konkretisht. Një kryeministër me fol edhe

për shëndetësi, edhe për arsim, edhe për infrastrukturë duke i pasur ministrat këtu. Si ka mundësi. Atëherë po del që ti ministrat i ke të paafte. Do të thotë se barrën e gjithë qeverisë e ke marrë ti. Pse s'e zbardhët rastin për katër vjet, plus 1 vit e gjysmë. Përkundrazi i keni zhdukë, i keni vjedhur mostrat, e keni ndjekë IML-në. Sot ushtarët po hanë bukë e pashtetë. Policia e ushtarët nuk kanë uniforma. Ti e ke degraduar secilin nivel të kësaj qeverisje. Keni vjedhur subvencionet dhe rezervat shtetërore. Keni vjedhë e keni sakatu", ka thënë Kadrijaj.

Nënshkruhet marrëveshja për formimin e Këshillave të Pacientëve

KAMENICË, 2 DHJETOR - Drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Kamenicë, Greta Kryeziu, ka

nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e të Drejtave të Pacientëve (PRAK) për themelimin e Këshillave të Pacientëve.

Sipas kësaj marrëveshje, këto këshilla do të shërbejnë si platforma për adresimin e sfidave dhe prioriteteve të pacientëve

në komunën e Kamenicës, duke promovuar transparencën dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore.



Pas sulmit kriminal në veri, vazhdojnë angazhimet policore në ruajtje të rendit dhe sigurisë publike

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Policia e Kosovës pas sulmit kriminal terrorist të ndodhur më 29 nëntor në veri të vendit ndaj infrastrukturës kritike në kanalën e ujit Ibër Lepenci, ka vazhduar realizimin e detyrave dhe autorizimeve kushtetuese dhe ligjore, duke aplikuar masa shtesë në interes të parandalimit të akteve të tilla kriminale, ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike si dhe ofrimit të sigurisë ndaj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pa dallim.

Sipas detyrës zyrtare, në bashkëpunim me organet e drejtësisë, njësitë kompetente policore kanë vazhduar veprimet policore në vendin e ngjarjes rreth hetimit, ekzaminimit dhe dokumentimit shtesë me dëshmi dhe fakte relevante që ndërliken me rastin. Njësitë policore gjate



aktiviteteve në këtë zonë dhe përreth saj, në një lokacion në fshatin Varagë të Zubin Potokut, kanë kryer kontrolle, me ç'rast si dëshmi materiale janë sekuestruar dy armë gjuetie, një armë karabinë M48 dhe një sasi e municionit të kalibrave të ndryshëm.

Po ashtu, aktivitetet policore kanë vazhduar edhe në Mitrovicë Veri, ku janë kryer kontrolle në dy lokacione, i cili ka rezultuar me shoqërimin në stacion policor të një personi të dyshuar për të vazhduar procedurat e mëtejme, si dhe si dëshmi materiale janë sekuestruar 1 pushke gjuetie, 1 armë forme lapsi kimik, 278 fishekë të kalibrave të ndryshëm, përfshirë edhe të armës së gjuetisë, 3 thika, 5 emblema, 1 shall maskues me kapele, 1 audio incizues, 1 USB, 1 bateri dore, 1 këllëf për pistoletë, 1 rrip brezi taktik, 1 sprej, 3 krehër të zbrazet për fishek, 1 karikator për pistoletë dhe 1 radiolidhje me adapter.

“Ruajtja e rendit kushtetues dhe sigurisë publike, ruajtja e pronës publike dhe private, zbatimi i ligjit në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase, si dhe ofrimi i sigurisë ndaj të gjithë qytetarëve pa dallim, mbetet detyrë dhe përkushtim i vazhdueshëm i Policisë së Kosovës”, theksohet në njoftimin për medie.

Policia e Kosovës bëri me dije se ka arrestuar edhe një person i cili dyshohet të jetë i lidhur me sulmin ndaj kanalit të ujit të Ibër-Lepencit në Zubin Potok më 26 nëntor.

Personi i dyshuar, i identifikuar me initiale J. V., u arrestua në orët e mbrëmjes të 1 dhjetorit, “nën dyshimin që mund të ketë pasur rol të rëndësishëm në kuadër të grupit përgjegjës për rastin e sulmit terrorist ndaj infrastrukturës kritike”, u tha në njoftim.

Autoritetet gjyqësore ndaj të dyshuarit kanë caktuar masën e ndalimit prej 48-orësh.

80-vjetori i lindjes, Osmani vendos lule te shtatorja e Rugovës



PRISHTINË, 2 DHJETOR - Me rastin e 80-vjetorit të lindjes së presidentit historik Ibrahim Rugova, e para e shtetit, Vjosa Osmani, ka vendosur lule te

shtatorja e tij. Ajo ka thënë se në historinë e shtetit tonë shkëlqen një emër që mishëron guximin, urtësinë dhe ëndrrën tonë për shtet të pavarur - Dr.

Ibrahim Rugova, ati themeltar dhe presidenti historik. “Me besim të pafund në paqen, dinjitetin, lirinë dhe pavarësinë e popullit tonë, presidenti Rugova hodhi themelet e një Kosove të pavarur, duke formësuar një trashëgimi të rrënjësor në mençurinë, durimin, qëndrueshmërinë dhe vullnetin e pathyeshëm të një kombi. Me urtësinë, me vizionin e një burrështetasi dhe me shpirtin e një patrioti, presidenti Rugova na bashkoi në momentet tona më të vështira, duke frymëzuar brezat për të ecur në rrugën e lirisë, pavarësisë dhe demokracisë. Rugë nga e cila asnjëherë nuk do të heqim dorë”, ka thënë presidentja Osmani.

Abdixhiku viziton familjen Rugova

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Në 80-vjetorin e lindjes së ish-presidentit Ibrahim Rugova, kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka vizituar familjen Rugova. “Vizitën e bëra i shoqëruar me udhëtarët e bashkëpunëtorët e ngushtë të presidentit; udhëtarë e bashkëpunëtorë të mi edhe sot, profesor Alush Gashin dhe profesor Muhamet Hamitin. Në traditën tashmë të përvjetme të shënimit të kësaj ditëlindjeje, zonja

Fana kishte përgatitur ëmbëlsirën Tiramisu, të preferuarën e presidentit; të shijuar për herë të parë në Romë. Presidenti ka vetëm ditëlindje! 80 vite më parë, lindi shqiptari më i madh i kohërave. Pjesa tjetër është një histori e paarritshme, e papërsëritshme. Ajo na qëndron sot si dritë udhërrëfyese për të bërë të ardhmen!”, ka shkruar Abdixhiku në “Facebook”.



Në Urgjencën e re në Podujevë fillon dhënia e shërbimeve shëndetësore

PODUJEVË, 2 DHJETOR - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me drejtoreshën e Shëndetësisë, Adelina Stublla, e kanë vizituar urgjencën e re, ku aty tashmë do të ofrohen shërbimet shëndetësore.

Kryetari Bulliqi gjatë kësaj vizite ka takuar stafin shëndetësor, të cilëve u ka uruar suksese dhe punë të mbarë në objektin e ri. “Theksova rëndësinë e përkushtimit të tyre për të garantuar shërbime sa më

cilësore për pacientët. Urgjenca e re ofron kushte moderne dhe të favorshme jo vetëm për stafin, por edhe për pacientët, të cilët tashmë do të kenë qasje në një hapësirë të re dhe shumë të përshtatshme për nevojat

mjekësore. Urime dhe suksese stafit shëndetësor dhe të gjithë qytetarëve!”, tha kryetari Bulliqi. Në objektin e vjetër të emergjencës edhe më tutje mbetet Shërbimi i Infuzioneve dhe kujdestaria e natës.



Gazetari Drin Ejupi i bashkohet PDK-së, garon edhe për deputet

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Gazetari Drin Ejupi i është bashkuar të hënën PDK-së. Ai do të jetë edhe pjesë e listës për deputet në zgjedhjet e 9 shkurtit. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se me Drin Ejupin në ekip, PDK-ja e ka më të lehtë ta përfaqësojë denjësisht Prishtinën. "I njohur për qasjen e tij inovative dhe arritjet profesionale, me një eksperiencë të pasur dhe vizion të qartë, Drini fuqizon

listën tonë për deputetë. Fitues i çmimeve për gazetari në Kosovë e i nominuar edhe për çmime ndërkombëtare, Drini për afro 15 vjet në dy televizione nacionale, ishte në shërbim të qytetarëve në çdo cep të Kosovës me tema e sfida të mëdha", tha kreu i PDK-së. Ndërkaq Ejupi i ka ftuar qytetarët t'i bashkohen në misionin e tij për një Kosovë më të mirë. "Ashtu sikur në gazetari që e kam ndjekur të vërtetën, njëjtë e kam misionin

të qartë në rrugëtimin tim të ri në politikë, me punu me të vërtetën për një ambient e debat politik më pozitiv në parlament. Për më pak burokraci, më shumë efikasitet, për media më të lira, për një drejtësi më të pavarur, për qytetarin më shumë të lidhur me sportin, pasi aty është shëndeti, aty është qetësia, mbi të gjitha, bashkë për një zhvillim shoqëror ekonomik të qëndrueshëm", është shprehur Drin Ejupi.



Kumanova regjistron disa zjarrvënie që dyshohet të jenë kryer qëllimshëm

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Në orët e para të mëngjesit të së hënës në Kumanovë janë regjistruar disa raste të zjarrvënieve të dyshuara si të qëllimshme.

Zjarret kanë përfshirë një lokal afarist, një pjesë të një shtëpie dhe disa vetura, mes të cilave edhe atë të prokurorit të lartë, Xhelal Bajrami.

Në një deklaratë për "Radion Evropa e Lirë", prokurori Bajrami tha se organet kompetente të sigurisë dhe prokurori kujdestar kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë siguruar prova të mjaftueshme materiale për të ndihmuar në zbardhjen e rastit. "Mendoj se bëhet fjalë për ndonjë kriminel, apo grup kriminelësh që kanë ndërmarrë këtë veprim", tha Bajrami.

Ai përjashtoi çdo motiv politik lidhur me ngjarjen. "Nuk dua t'i jap kësaj ngjarjeje ndonjë konotacion tjetër, por mendoj se është thjesht një akt kriminal. Nuk kam dyshim në ndonjë person. Nuk besoj se ka ndodhur me prapavijë politike, aq më tepër sepse unë nuk merrem me politikë prej më shumë se 10 vitesh dhe e përjashtoj këtë mundësi", shtoi Bajrami.

Përkundër prokurorit Bajrami, opozita shqiptare, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI), përmes një komunikate, siç e quajti "të jashtëzakonshme" për media, akuzoi qeverinë dhe institucionet në Maqedoninë e Veriut që, siç thanë, "nuk po arrijnë të garantojnë siguri për qytetarët", dhe kërkoi edhe ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar. "Bashkimi



Demokratik për Integrim bën thirrje për ndërhyrje urgjente nga faktori ndërkombëtar. Qartë është bërë e ditur se nga kjo qeveri e verbuar dhe e njëanshme nuk mund të presim as drejtësi dhe as përgjegjësi. Vetëm një presion ndërkombëtar mund të ndalojë këtë spirale të rrezikshme të dhunës dhe urrejtjes, e cila po kërcënon paqen dhe stabilitetin në vend", thuhet në kumtesën e BDI-së.

Nga kjo parti thanë se mesazhi që po dërgohet është se

"shqiptarët në këtë vend janë të lënë në mëshirën e fatit". "Ne kërkojmë që këto sulme të hetohen menjëherë dhe autorët të sillen para drejtësisë. Shqiptarët nuk do të qëndrojnë më të heshtur përballë kësaj padrejtësie, dhe ne do të përdorim çdo mjet demokratik për t'i mbrojtur të drejtat dhe dinjitetin e qytetarëve tanë". Në qytetin e Kumanovës zjarr i është vënë edhe zyrës së kontabilitetit dhe përkthimeve gjyqësore, e cila ndodhet përballë Gjykatës së atjeshme

Themelore. Ky subjekt figuron në emrin e Fitor Jakupit, këshilltar i BDI-së në Kuvendin Komunal të Kumanovës. Makina ka tentuar t'i digjet edhe një koloneli me inicialet E. D., por që është përfshirë vetëm pak nga flaka. Raportohet se është djegur edhe një tjetër makinë, kurse flakët e zjarrit kanë kapluar edhe një pjesë të shtëpisë ku ka qenë e parkuar. Bëhet me dije se Prokurori Publik kujdestar ka dalë në vendin e ngjarjes për t'i zbardhur rrethanat e djegies së

të paktën dy veturave dhe një objekti afarist.

Prokuroria tha se janë siguruar prova nga vendi i ngjarjes që do të jenë objekt ekspertize, ndërkohë që po kontrollohen edhe kamerat e sigurisë.

Por, jozyrtarisht mësohet se në asnjë prej vendeve ku është vënë zjarri nuk kanë punuar kamerat e sigurisë. Grupi hetimor nuk përjashton mundësinë që të dyshuarit të kenë përdorur bllokues të internetit, që ndërpret filmimet në kamerat e sigurisë.

Ministrja Gërvalla merr pjesë në takim të Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka udhëtuar sot për në Bruksel, ku do të marrë pjesë në takimin e Komitetit për Punë të Jashtme të Parlamentit Evropian.

Ministrja Gërvalla do ta paraqesë situatën aktuale të sigurisë në Kosovë pas sulmit të

Serbisë ndaj infrastrukturës kritike të Kosovës në Zubin Potok, duke adresuar veprimet destabilizuese të vazhdueshme të Serbisë dhe domosdoshmërinë që institucionet e reja të Bashkimit Evropian të ndërmarrin masa të menjëhershme për ta parandaluar përsëritjen e akteve të tilla që rrezikojnë paqen dhe stabilitetin në rajon. Në këtë

takim ministrja do ta theksojë nevojën për një qasje të re dhe më të vendosur nga institucionet e reja të BE-së bazuar në parimet e paqes dhe stabilitetit afatgjatë. Gjithashtu, ajo do ta ripërsërisë rëndësinë e përsheptimit të procesit të integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian si dhe mbështetjen për shtetet e Ballkanit me orientim properëndimor.



Ish-guvernatori i BQK-së: Kosova ofron shumë mundësi për bizneset amerikane

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se Kosova ofron shumë mundësi për bizneset amerikane. “Këto ditë, për nder të festave të nëntorit, në veçanti Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë, pata nderin të jem i ftuar nga Rrjeti i Biznesit Shqiptar të Diasporës për të festuar me shqiptarët në Dallas, Teksas, ShBA. Për këtë ftesë, dua ta falënderoj presidentin e Rrjetit Global të Bizneseve të Diasporës Shqiptare dhe

bashkëpunëtorët e tij. Gjatë aktiviteteve në ShBA pata rastin të takoj personalitete të shquara të diasporës shqiptare si dhe miq amerikanë me të cilët diskutuam për mundësitë që ofron Kosova për të sjellë investime në shtetin më të ri të Evropës”, ka bërë me dije Mehmeti.

Ai ka theksuar se gjatë kësaj vizite ka pasur mundësi të shohë nga afër arritjet e komunitetit shqiptar dhe të diasporës së Kosovës në fusha të ndryshme, veçanërisht në ekonomi dhe biznes. “Në

prezantimin tim në ShBA fola për mundësitë që Kosova ofron për bizneset e huaja, në veçanti për ato amerikane. Kosova nuk është vetëm një vend miqësor për bizneset amerikane, por është edhe një vend ku, nëse investohet, mund të prodhohet dhe eksportohet me sukses. Për investitorët e huaj, Kosova ofron përfitime nga taksat konkurruese, një fuqi punëtore të talentuar, mundësi për arsimim, kërkim dhe inovacion. Përveç kësaj, lidhshmëria, infrastruktura



dhe grupimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) krijojnë

bazat për zhvillimin e bizneseve profitabile”, ka thënë Mehmeti.

Rrugët që mbeten në ndërtim e sipër

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Gati në çdo anë të Kosovës shumë rrugë magjistrale janë në ndërtim e sipër prej vitesh.

Ndonëse të parapara për të lidhur qytete nga njëri cep në tjetrin, shumë prej tyre mbeten pa u përfunduar, duke lënë pas pluhur, gropa e vështirësi të tjera në qarkullim.

Si arsye për këto vonesa, zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmendin: shembjet e dheut, problemet me shpronësime, shkëputjen e kontratave me kompanitë që s'i kanë kryer punimet e të tjera.

Por, askush prej tyre nuk thotë se kur do të përfundojnë ato.

E nisur qysh në vitin 2009, magjistralla Prishtinë - Mitrovicë nuk ka përfunduar ende.

Vlera totale e kësaj rruge të gjatë 40 kilometra është mbi 100 milionë euro.

Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, tha më 22 nëntor se punimet në segmentin Prishtinë-Vushtrri - pjesë e kësaj rruge - “prit të përfundojnë së shpejti”, por nuk specifikoi më shumë. “Tani po punohet për shtrimin e shtresës së tretë dhe të fundit të asfaltit, ndërtimin e trotuareve, vendosjen e shenjave të komunikacionit dhe pajisjeve mbrojtëse”, tha ai në një konferencë për medie.

Sa i përket pjesës tjetër të magjistrales, që shtrihet në drejtim të Mitrovicës, ministri nuk dha ndonjë afat, duke thënë vetëm se punimet janë duke vazhduar “me intensitet të lartë”.

Punimet me intensitet të shtuar



nisën në shkurt të këtij viti, kur Qeveria e Kosovës ndërpreu kontratën me konsorciumin e mëparshëm për shkak të “parregullsisë” dhe përzgjedhi një kompani të re.

Që në atë kohë Aliu tha se segmenti në fjalë do të përfundojë në fillim të vitit 2025.

“Radio Evropa e Lirë” kontaktoi ministrin që udhëheq ai, për ta pyetur më në detaje rreth punimeve në këtë magjistrallë dhe të tjera, por nuk mori përgjigje.

Në ndërtim prej vitesh është edhe magjistralla Prishtinë - Podujevë.

E gjatë 30 kilometra, ajo kap vlerën e mbi 41 milionë eurove. Projekti ka nisur qysh në vitin

2015, ndërsa punimet në zgjerimin e segmentit të mbetur kanë nisur vitin e kaluar, pas përfundimit të procesit të shpronësimit.

Pasi nuk mori përgjigje nga Ministria e Mjedisit, “REL”-i pyeti kryetarin e komunës së Podujevës, Shpëtim Bulliqi, se kur do të përfundojë magjistralla. “Shpresoj brenda këtij viti... Nëse premtim moti, traseja e asfaltuar do të jetë e përfunduar, kurse finesat e tjera, si mburojat, disa trotuare, vitin tjetër”, tha ai.

Punimet në 30 kilometra të magjistrales Prishtinë - Pejë kanë nisur në vitin 2018, por as ato nuk kanë përfunduar. “Nuk e dimë se kur do të lëshohet për qarkullim [kjo pjesë]”, thotë

shkurtimisht për “Radion Evropa e Lirë” nënkryetari i komunës së Pejës, Fatmir Asllani.

Ai shton se komuna nuk ka asnjë informacion nga Ministria e Mjedisit në lidhje me këtë projekt. Vlera e këtij projekti është rreth 200 milionë euro.

Një tjetër projekt që ka nisur në vitin 2018, e që nuk ka përfunduar, është autostrada Prishtinë - Gjilan.

Mbi 22 kilometrat e planifikuara është thënë fillimisht se do të përfundonin brenda 30 muajsh, përkatësisht në fund të vitit 2020. Kur është shpallur projekti para gjashtë vjetësh, kostoja e tij ka qenë 87 milionë euro. Por, në buxhetin e miratuar për vitin e

ardhshëm kushton 126 milionë euro.

Sipas zyrtarëve, në këtë kanë ndikuar parregullsitë, shembjet e dheut dhe shpronësimet.

Ministri Aliu ka thënë në një konferencë për medie në muajin tetor se kjo autostradë është projekti i vetëm për të cilin “përton të flasë”. Megjithatë, një muaj pas, ai ka thënë se angazhimi më i madh gjatë këtij viti është përqendruar te ky projekt.

Se kur do të përfundojë nuk ka dhënë detaje. “Të gjitha problemet dhe zvarritjet kanë ndodhur si pasojë e mungesës së një studimi të mirëfilltë përpara fillimit të punimeve”, ka thënë Aliu.

Kjo autostradë pritet ta lidhë Kosovën me Serbinë jugore, përkatësisht me Luginën e Preshevës.

Kosova i ka të përfunduara dy autostrada që e lidhin me shtetet e rajonit.

Autostrada e parë e përfunduar në vitin 2012 është ajo që e lidh me Shqipërinë, e quajtur “Rruga e Kombit - Ibrahim Rugova”.

Në vitin 2019, ndërkaq, ka përfunduar autostrada “Arbën Xhaferi”, e cila shtrihet nga Prishtina në Han të Elezit, në kufi me Maqedoninë e Veriut.

Gjatë dy dekadave të fundit Kosova një pjesë të madhe të investimeve kapitale e ka çuar në ndërtimin e rrugëve lokale dhe magjistrale.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2023, nga gjithsej 2 434.0 kilometra rrugë, 2 384,3 kilometra kanë qenë të asfaltuara dhe rreth 50 kilometra të paasfaltuara.

KEK-u e ndal njësinë B1 për dy ditë: Do të kryhet një kontroll

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se në minutat e para pas mesnate është ndalur njësinë B1, sipas një planifikimi të mëhershëm. Sipas një njoftimi, gjatë kësaj ndalesë të shkurtër

dyditore do të kryhet një kontroll teknik i pajisjeve dhe eliminimi i defekteve. “Ky proces pritet të përfundojë nesër gjatë ditës dhe njësinë do të kthehet në prodhim në mbrëmje, rreth orës 20:00. Kjo

ndalesë është e nevojshme për të siguruar që njësinë të jetë në kushte optimale për prodhim dhe për ta garantuar vazhdimësinë dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike”, thuhet në njoftim.



Lufta hibride në prag të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë



Shkruan: **Bekim ÇOLLAKU**

Sa më shumë po afrohen zgjedhjet parlamentare, aq më tepër po shtohen tensionet në veri të Kosovës. Këto zhvillime, që kulmuan me një akt tjetër terrorist kundër asetëve vitale të Kosovës, kuptohet që janë të qëllimshme dhe synojnë destabilizimin e vendit tonë. Nuk ka dyshim, fajtoreshë mbetet Serbia ose Rusia. Përderisa teoritë e tjera konspirative mbesin të hapura, shtrohet pyetja se përveç Serbisë dhe Rusisë, kujt tjetër i përshtatet një përkeqësim i tillë i situatës së sigurisë në prag të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë?

Pas aktit të fundit terrorist kundër infrastrukturës vitale, situata është alarmante. Ndjenja e pashmangshme është sikur jemi në prag të luftës. Për të kuptuar se a bëhet fjalë për një luftë klasike apo hibride, mjafton t'i lexosh deklaratat e kryeministrit Kurti. Në fakt, frika e krijuar se jemi në prag të një lufte nuk e ka burimin vetëm te veprimet terroriste të sponsorizuara nga Serbia apo Rusia. Ndjenja e pasigurisë dhe frika nga lufta eventuale është gjithashtu rezultat i një strategjie të partisë shtet dhe gjuhës luftënxitëse të liderit suprem. Sigurisht që kjo strategji e partisë shtet është pjesë e luftës hibride që bëhet për t'i arsyetuar dështimet e kësaj qeverie dhe për t'i mbuluar skandalet. Në një përpjekje të tillë të dëshpëruar për ta arsyetuar qeverisjen e dobët, kryeministri identifikon si fajtor permanent Serbinë, Rusinë dhe pastaj rendit Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, komplet sistemin

prokurorial, mediat e lira, shoqërinë civile, partitë opozitare etj.

Ndërsa hetimet për t'i zbuluar kryerësit e aktit terrorist të fundit kundër infrastrukturës jetike janë duke vazhduar, kryeministri është mbushur plot adrenalinë jo vetëm në riparimin e dëmeve të shkaktuara, por edhe në ngritjen e retorikës për përshkallëzim deri në luftë eventuale. Kështu, në përgjigje të kërkesës së tij, Këshilli i Sigurisë së Kosovës ka aprovuar masa shtesë për të forcuar sigurinë rreth objekteve vitale si ura, trafostacione, antena, liqene, kanale, etj. Përkundër faktit që Këshilli i Sigurisë nuk e ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është aktivizuar në terren për këtë qëllim. Askush nuk e ka të qartë bazën ligjore mbi të cilën është marrë një vendim i tillë. Ndoshta kjo do të mund të sqarohet nga institucionet përgjegjëse në ditët në vijim. Mirëpo, tendencat e kryeministrit për të marrë kompetenca shtesë në fushën e sigurisë, në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet në fuqi, tashmë janë të njohura për opinionin publik. Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet të ushtrojë detyrën e tij për kontrollin civil mbi institucionet e sigurisë.

Në këtë situatë tepër të ndjeshme dhe plot tensione, çuditërisht kryeministri gjen kohë dhe pa fije turpi sërish provon ta fajësojë ish-presidentin Hashim Thaçi për letrën sqaruese dërguar NATO-s shumë vite më parë lidhur me vendosjen apo

operacionet e FSK-së (e cila në atë kohë kishte një mandat dhe mision krejtësisht tjetër) në veri të vendit. Si mund të jetë një njëri, në këtë rast një kryeministër, kaq i lig dhe të bëj përpjekje për ta lënduar ish-presidentin, i cili për më tepër se katër vite mbahet i burgosur në Hagë. Fundja, është paradoksale të mendohet se liderin suprem e pengon ajo copë letre për ta urdhëruar FSK-në t'i ruajë asetet vitale shtetërore në veri të vendit. Apo ndoshta, ajo copë letre thjesht i shërben kryeministrit për ta arsyetuar mungesën e guximit për të marrë vendime shtetërore? Kryeministër, pse nuk provon një herë të vetme të bësh një veprim racional, të cilin je i detyruar ta bësh sipas ligjit në fuqi – siguro mbështetjen financiare për të akuzuarit nga Gjykata Speciale. Bëje tani, sepse je vonuar dhe turpëruar.

Tash e dy vite, qeveria e Albin Kurtit përpiqet të bindë opinionin vendor e ndërkombëtar se veprimet e saj në veri të Kosovës kanë vendosur siguri për qytetarët, përfaqësim demokratik politik dhe mbarëvajtje të shërbimeve publike. Megjithatë, vetëm në tri ditët e fundit, aktet terroriste pranë objekteve publike në Zvečan e Zubin Potok, që kulmuan me shkatërrimin e kanalit të Iber-Lepencit përmes shpërthimit me dinamitin e kurdisur – dëshmuar krejtësisht të kundërtën. Si rrjedhojë, vendi ynë po kërcënohet me përshkallëzim të sigurisë nacionale – përshkallëzim ky që vjen si pasojë jo vetëm e veprimeve të Serbisë apo Rusisë,

por në masë të konsiderueshme edhe i qeverisë aktuale për shkak të udhëheqjes së papërgjegjshme të procesit të dialogut. Pranimi i pakujdesshëm i marrëveshjes bazike të Brukselit dhe aneksit të Ohrit, pastaj edhe i draftit të Zajednicës së tij të dashur në njërën anë, ndërsa në anën tjetër refuzimi i implementimit të tyre, vazhdon të prodhojë rrezik nga sabotazhet politike dhe aktet terroriste që synojnë destabilizim të brendshëm dhe tensione rajonale.

Situata edhe pse duket shumë e komplikuar, ajo është e thjeshtë. Ne duhet të gjithë ta kemi të qartë: çdo gjë që po ndodhë ka motiv dhe konotacion elektoral – dhe asgjë më shumë. Këtë më së miri e vërtetoi vetë kryeministri Kurti, i cili në natën kritike menjëherë pas sulmit, në kërkim të mbështetjes partiake para fillimit të fushatës zgjedhore, keqpërdori aktin terrorist mbi infrastrukturën e Ibër-Lepencit për ta kërcënuar opozitën politike dhe për t'i heshtur mediat kritike – duke i cilësuar pjesë të luftës hibride kundër qeverisë së tij dhe, siç u shpreh 'kundër popullit të Kosovës dhe kombit shqiptar'. Heshtja e kritikës ndaj tij dhe qeverisjes së papërgjegjshme është synimi i vetëm i tij, i cili në konferencën për media dëshmoi se është i gatshëm që edhe aktet e sabotazheve terroriste t'i përdorë kundër oponentëve politikë dhe medieve kritike.

Me të tilla kërcënime të drejtpërdrejta, kryeministri Kurti po synon që përçarjen politike që e shkaktoi qeverisja e tij ta thellojë tutje, duke e shndërruar

atë në armë zgjedhore të cilën po ia drejton të gjithë atyre që po refuzojnë të jenë elektorat i tij. Në konferencën për media, Kurti dhe qeveria e tij kërkuan që në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare të ballafaqohen me armikun e jashtëm dhe regjimin e Aleksandar Vuçiqit në Serbi, kurse përmes partisë së tij dhe militantëve të rrjeteve sociale të konfrontohet me armikun e brendshëm nga radhët e opozitës demokratike, medieve të lira dhe shoqërisë civile.

Sjellja e kryeministrit, krahas dhe përtej cenimit kaq serioz të situatës së sigurisë në vendin tonë, dëshmojnë sa i pasigurt dhe i cenueshëm është bërë vendi ynë. Kjo situatë kërkon sjellje të përgjegjshme institucionale dhe bashkëveprim ndërinstitucional dhe pse jo, edhe koordinim me partitë opozitare. Tani na duhet qetësi e urti në mënyrë që situata e rënduar të shkojë kah stabilizimi dhe qetësimi, jo kah përplasje e konfrontimi. Ne asnjëherë nuk duhet të pranohet ta shndërrojmë interesin e Kosovës, sigurinë e stabilitetin e saj, në bast elektoral. Kosova është më e madhe e më e rëndësishme sesa Albin Kurti dhe dëshira e tij për pushtet. Në këtë aspekt, kritikën ndaj qeverisë e mospajtimin me të, kurrë nuk duhet kuptuar si sulm ndaj shtetit tonë. Prandaj, qeveria aktuale nuk duhet të vërsulet me arsenalin e saj kundër armikut imagjinar të brendshëm. Qytetarët e Kosovës e duan shtetin e tyre në mos më shumë, atëherë po aq sa çdo qeveri apo kryeministër që i shërben atij.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Top pesëshja e basketbollisteve që shkëlqyen në javën e tetë

PEJË, 2 DHJETOR - Peja 03 fitoi në derbin që u zhvillua kryeqytet, duke mundur Prishtinën, ku Brailyn Jarell Joseph pati një paraqitje të mrekullueshme me 21 pikë, 19 kërcime, tri asistime, duke u ndihmuar nga Sara Vraniqi, e cila kontribuoi me 17 pikë, 11 kërcime dhe pesë asistime. Bashkimi fitoi ndaj Junior 06 duke regjistruar shtatë fitore dhe një humbje. Në përballjen që përfundoi me rezultatin 88:65, më e mira te

prizrenaset ishte Caterriion Thompson, me 37 pikë e katër kërcime. Në një ndeshje tjetër të rëndësishme, Penza fitoi ndaj Trepçës. Këtu paraqitja e Saranda Dacit

ishte e shkëlqyeshme me: 12 pikë, 13 kërcime, katër asistime dhe e Jeanae Terry, e cila ndihmoi skuadrën me 24 pikë, 10 kërcime dhe gjashtë asistime.

TOP PESËSHJA

(Brailyn Jarell Joseph KBF Peja 03) 21 pikë, 19 kërcime, 3 asistime
(Caterriion Thompson KBF Bashkimi) 37 pikë, 4 kërcime
(Jeanae Terry KBF Penza) 24 pikë, 10 kërcime, 6 asistime
(Saranda Daci KBF Penza) 13 pikë, 19 kërcime, 10 asistime
(Jayla Johson KBF Prishtina) 28 pikë, 9 kërcime



'Ylli i javës' në Superligë, Manaj: Synojmë edhe tri fitore



"Epoka e re"

GJILAN, 2 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e kaluar i është dhënë futbollistit të FC Drita, Arb Manaj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Lulzim Berishës, Sunaj Keqit dhe Selajdin Jerliut. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e pesëmbëdhjetë t'i jepet Arb Manajt, i cili asistoi në

golin e dytë dhe shënoi golin e tretë, duke qenë lojtari më i mirë i FC Drita në fitoren e rëndësishme kundër FC Ballkani (2:3) dhe duke i mundësuar ekipit të tij 3 pikë për shkëputje tetëpikëshe në krye të tabelës. Pasi mori këtë çmim, Manaj u shpreh i lumtur që u vlerësua si më i miri i javës. Ai me këtë rast ka bërë me dije se Drita, pas fitores ndaj kampionëve në fuqi, synon t'i fitojë edhe tri ndeshjet e radhës. "Ishte një ndeshje derbi dhe shumë e vështirë, pasi udhëtonim te FC Ballkani, i cili për dy vjet e gjysmë nuk ka pësuar në fushën e tij, por ne

arritëm ta fitojmë. Kemi katër ndeshje radhazi me fitore dhe shpresoj që t'i fitojmë të gjitha tri ndeshjet deri në fund të stinorit vjeshtor. Jam i lumtur me performancën time individuale, por më e rëndësishmja është që po arrij ta ndihmoj ekipin. Falënderimi më i madh shkon për bashkëlojtarët e mi", ka thënë Manaj për faqen zyrtare të FFK-së.

Pas 15-të ndeshjeve të zhvilluara në Superligë, Drita nga Gjilani kryesojnë tabelën me 34 pikë, gjashtë pikë më shumë se skuadra e dytë në tabelë, Malisheva.

FVK-ja pas dhunës në finale të Kupës: Aktorët e përfshirë duhet të japin llogari



PRISHTINË, 2 DHJETOR - Federata e Volejbollit e Kosovës ka dënuar ashpër incidentin e ndodhur pas përfundimit të ndeshjes finale të Kupës së FVK-së, e cila u zhvillua më 1 dhjetor në mes të KV Ferizaj dhe KV Peja. Ferizaj triumfoi ndaj Pejës, derisa pas ndeshjes volejbollistët pejanë u ofenduan dhe u gjuajtën me gjësende të forta nga tifozët vendas. "Volejbolli nuk njihet si sport i dhunshëm por, përkundrazi, njihet si një lojë që promovon bashkëpunimin,

respektin dhe garën e ndershme. Pikërisht për këtë arsye, ngjarje të tilla, që përfshijnë dhunë ose tensione, janë të papranueshme dhe bien në kundërshtim me rregullat, frymën dhe vlerat që ky sport synon të përcjellë", thuhet në reagim.

FVK-ja zotohet se në bashkëpunim me të gjitha institucionet dhe instancat përkatëse do t'i ndërmarë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që të gjithë aktorët e përfshirë në ngjarje të tilla të

japin llogari për veprimet e tyre. "Ky angazhim reflekton përkushtimin e FVK-së për ta ruajtur integritetin dhe vlerat e sportit, duke u siguruar që sjelljet e papranueshme të mos tolerohen. Ky qëndrim i vendosur synon të dërgojë një mesazh të qartë se volejbolli dhe sporti në përgjithësi duhet të mbeten hapësira të respektit, 'fair-play'-it dhe pasionit, duke larguar çdo formë sjelljeje që dëmton këto parime", thuhet në reagimin e FVK-së.

Përfundon turneu i YDF-së në Maqedoninë Veriore, Kosova pa asnjë fitore

PRISHTINË, 2 DHJETOR - Nga 26 nëntori deri më 1 dhjetor është zhvilluar turneu i FIBA YDF-së në Shkup të Maqedonisë Veriore. Pjesë e Programit të FIBA-s janë Kosova, Maqedonia Veriore, Rumania, Bullgaria dhe Turqia

në të dyja konkurrencat me U14. Në këtë garë Kosova ka zhvilluar nga katër ndeshje, në të dyja konkurrencat, derisa synimi është zhvillimi i gjeneratave të reja, të fitojnë përvojë dhe një ditë të jenë pjesë e rëndësishme në

basketbollin e Kosovës. FVK-ja dhe FIBA YDF kanë bashkëpunim që nga viti 2016, bashkëpunim ky i cili ka ndihmuar në zbulimin e talentëve të rinj, edukimin e trajnerëve dhe ngritjen profesionale të lojtarët.

REZULTATET

Bullgaria-Kosova (femrat)	59:19
Bullgaria-Kosova (meshkujt)	97:43
Kosova-Rumania (femrat)	24:51
Kosova-Rumania (meshkujt)	55:64
Kosova-Turqia (femrat)	34:83
Kosova-Turqia (meshkujt)	35:83
Kosova-Maqedonia Veriore (femrat)	28:40
Kosova-Maqedonia Veriore (meshkujt)	37:57



Daliqi do të largohet papritur nga Kombëtarja e Kroacisë

Zagreb, 2 dhjetor - E ardhmja e Zlatko Daliq duket se është larg Kombëtares së Kroacisë dhe ai do të largohet nga ekipi kombëtar pas shtatë vjetëve. Mediumi nga Katari, "Al Raya", pretendon se trajneri aktual i kombëtares kroate, Zlatko Daliq, ka arritur marrëveshje

me kombëtaren e Katarit. "Al Raya" pretendon se do ta zëvendësojë trajnerin aktual Felix Sanchez Lopez dhe do ta fillojë menjëherë punën, pasi kombëtarja e Katarit pritet të luajë në Kupën e Gjirit në Kuvajt këtë muaj. Kontrata e Daliqit me HNS zgjat deri në

verën e vitit 2026 dhe planifikohet që ai ta drejtojë kombëtaren në finalen e Ligës së Kombeve dhe kualifikimet për Botërorin e vitit 2026, si dhe vetë Kupën e Botës, nëse e fiton Kroacia. Katari pretendon se gjithçka është rënë dakord dhe se e gjithë

marrëveshja do të zyrtarizohet së shpejti. Le të shtojmë se Daliq mori Kroacinë më 7 tetor 2017 dhe deri më tani ka udhëhequr bardhekuqtë në 93 ndeshje dhe ka arritur 50 fitore, 24 humbje dhe 19 barazime. Ai fitoi medaljen e argjendtë dhe



të bronzit në Kampionatin Botëror 2018 dhe 2022 dhe të argjendtën në Ligën e Kombeve.

Verstappeni shfryn ndaj Russellit: Nuk e duroj dot, e humba të gjithë respektin që kisha për të

LOSAIL, 2 DHJETOR - Pas fitores së jashtëzakonshme në garën dramatike të Çmimit të Madh të Katarit në Losail, e parafundit për sezonin 2024 të Formula 1, katër herë kampioni i botës, Max Verstappen, shfryu publikisht ndaj George Russellit, duke përdorur tone shumë të ashpra. Holandezit të Red Bullit nuk i pëlqeu aspak penalteti i dhënë nga komisarët e FIA-s, që i hoqën atij "pole position"-in në favor të britanikut të Mercedesit. Penalteti ishte i çuditshëm, si për shkeljen e pretenduar, ashtu edhe për kohën dhe mënyrën e dhënies së tij (një zbritje prej vetëm një pozicioni në nisje). 27 vjeç nga Hasselt iu vu në dukje se kishte ngadalësuar shumë në një xhiro të ftohjes, duke penguar Russellin në një kthesë, megjithëse edhe ky i fundit nuk ishte në një xhiro të shpejtë. Sipas asaj që Verstappen shpjegoi në deklaratën e tij publike pas garës, penalteti erdhi si rezultat i presioneve të jashtëzakonshme që George Russell i bëri FIA-s gjatë takimit me komisarët e F1 pas kualifikimeve (një thirrje që erdhi pas ankesave të Russellit



në radio). Ky veprim e zemëroi kampionin katër herë të botës, i cili e akuzoi rëndë kolegun e tij më të ri: "Mënyra se si piloti tjetër (George Russell) e menaxhoi situatën gjatë mbledhjes me komisarët, sinjerisht nuk kishte kuptim. Kam shumë respekt për pilotët e tjerë, por pas asaj nate humba të gjithë respektin që kisha për të. Ishte thjesht qesharake mënyra se si Russell bëri presion për të më dhënë një penaltet. U zemërova shumë me të". Në konferencën për shtyp, Verstappen ishte edhe më i qartë: "Kam qenë në dhomën e

mbledhjeve (të komisarëve të FIA-s) shumë herë, por nuk kam parë kurrë dikë të bërtasë në mënyrë kaq agresive. E humba të gjithë respektin që kisha për të". Por shfryrja e Verstappenit nuk u ndal me kaq. Holandezi, si gjithmonë pa doreza, e akuzoi Russellin për hipokrizi dhe deklaroi se kishte ndërprerë përfundimisht çdo lloj marrëdhënieje miqësore me të: "Para kamerave duket shumë i arsyeshëm, por jashtë tyre është një person krejtësisht ndryshe. Nuk e duroj dot. Më mirë të shkoj diku tjetër. Nuk dua të kem më asnjë lidhje me të".

Clevelandi fiton sfidën e kreut me Bostonin

OHIO, 2 DHJETOR - Ndeshjet e radhës në NBA kanë dhuruar spektakël, siç është fitorja me rezultat 115-111 e kryesuesve të Clevelandit ndaj kampionëve në fuqi të Bostonit. Ndeshje me rivalitet deri në fund, ku për cavaliersin shkëlqeu Donovan Mitchell me 35 pikë, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Tatumit për Celticsin. Në kahun tjetër të NBA-s, Houstoni mundi me rezultat 119-116 Oklahoman dhe tashmë të dyja ekipet kryesojnë renditjen në Perëndim. Fred van Vleet me 38 pikë ishte lider për Houstonin. Fitore në sekondën e



fundit korri ekipi i lakersave, që mundi me rezultat 105-104 Utah Jazzin. Dyshja Davis - James realizoi 60 pikë së bashku. Fitore të rëndësishme korri skuadra e clippersave, që mundi me rezultat 126-122 Denverin, një përballje mes dy ekipesh pretendente. James Hardeni me

39 pikë e 11 asistime bëri dallimin në fushë. Jashtë fushës fitoi skuadra e Dallasit, që triumfoi me rezultat 137-131 ndaj Portlandit falë 36 pikëve e 13 asistimeve të Luka Doniqit.

REZULTATET

Memphis - Indiana	136-121
Brooklyn - Orlando	92-100
Toronto - Miami	119-116
New York - New Orleans	118-85
Cleveland - Boston	115-111
Houston - Oklahoma	119-116
Utah Jazz - Lakers	104-105
Sacramento - San Antonio	125-127
Portland - Dallas	131-137
Clippers - Denver	126-122

Valladolidi shkarkon trajnerin Pezzolano

Humbja e rëndë kundër Athleticos së Madridit (0-5) i ka kushtuar shtrenjtë Paulo Pezzolanos. Trajneri uruguaiian nuk është më

në krye të Real Valladolidit, siç e shpalli klubi spanjoll në një njoftim: "Pezzolano nuk do të jetë më trajner i Real Valladolidit.

Rrugët e Real Valladolidit dhe Paulo Pezzolano ndahen. Trajneri uruguaiian nuk do të vazhdojë në Pucela pas 70 ndeshjeve zyrtare

në tri sezone, gjatë të cilave fitoi një promovim (ngjitjen në La Liga). Klubi falënderon Pezzolanon për paraqitjet me

ngjyrat bardhë-vjollcë dhe i dëshiron fat të mbarë në fazën e tij të re personale dhe profesionale".

SHKURT

Kosova me pesë boksierë në Kroaci

Kosova do të marrë pjesë në turneun ndërkombëtar "Grand Prix" në Zagreb me pesë boksierë. Ky turne do të mbahet nga data 4 deri më 7 dhjetor. Selektori i Përfaqësueses së Kosovës në boks, Faton Xhakli, ka përzgjedhur pesë boksierë: Bashkim Bajoku (54 kg), Lorent Murati (63.5 kg), Shpëtim Bajoku (67 kg), Loris Idrizi (67 kg), Shpejtim Shabani (92+).

Peja, kampione e Kosovës në tenis

Klubi i Tenisit, Peja, është shpallur kampione e Kosovës në konkurrencën ekipore. Në finale tenistët pejanë mposhtën Prizrenin me rezultat të përgjithshëm 2-1. Pikën e parë Pejës ia siguroi Skënder Katana i cili ishte më i mirë se Arbin Koro. Në meçin e dytë, pas një drame të madhe, Stefan Micov shënoi fitore ndaj Mal Agushit, duke barazuar rezultatin në 1-1. Titullin e kampionit të Kosovës e vendosi meçi në çifte, ku dyshja e Pejës Katana/Agushi mposhtën kombinimin prizrenas Micov/Zulji dhe me meritë e fituan trofeun e çmuar. Paraprakisht në gjysmëfinale Peja nuk pati problem në përballje me klubin prishtinas DielliX derisa Prizreni me 2-1 eliminoi Prishtinën.

Guardiola: Nuk e prisja këtë në 'Anfield'

Liverpooli ka shënuar fitore në derbi ndaj Manchester Cityt. "Reds" në shtëpi mposhti me rezultat 2-0 "Citizens" në kuadër të javës së 13-të në Premierligë. Gjatë ndeshjes, tifozët e Liverpoolit nisën në kor t'i drejtoheshin trajnerit të Manchester Cityt, Pep Guardiola, se do të shkarkohej në mëngjes, teksa ai çoi 6 gishta, për t'i treguar titujt e fituar në elitën e futbollit anglez. E pas ndeshjes, ai foli rreth kësaj situatë. "Ndoshta kanë të drejtë! Nuk e prisja këtë në 'Anfield'. Ndoshta duhet ta kishin kënduar më parë. Nuk e prisja nga njerëzit e Liverpoolit, por është në rregull!", u shpreh Guardiola për "Sky Sports".

Slot: Askush nuk e kishte parashikuar një fillim të tillë

As në ëndrrat më të bukura Liverpooli nuk e kishte parashikuar një fillim të tillë të sezonit, duke u shkëputur 9 pikë nga ndjekësit në Premier Ligë pa ardhur Krishtlindjet. Fitorja 2-0 ndaj Manchester City konfirmoi dominimin e "Reds"-it, duke mundur një rival të drejtpërdrejtë. Arne Slot, trajner i drejtuesve të Premier Ligës, u shpreh: "Një ndeshje pothuajse perfekte nga ana jonë. E pritshme nëse shikoni ritmin e punës, ndaj mendoj se ishte një lojë e mirë. Sasia e rasteve që humbëm e bëri lojën shumë afër, por ndoshta ky është një aspekt pozitiv për ndeshje të tilla". "Do të ishte më mirë ta shënonim golin e dytë më herët. Ne gjithmonë bëjmë presing lart, por te City janë shumë të mirë në organizim. Lojtarët tanë kishin energji por, përveç lojtarëve, edhe publiku ishte fantastik. Ata të vënë gjithmonë në veshitësi me mënyrën se si e pozicionojnë veten", ka deklaruar Slot. "Ne kemi lojtarë cilësorë, jemi një ekip i vështirë për t'u mposhtur, por duhet të punojmë shumë. Kemi lëndime. Na është dashur të heqim Trent. Do të kishte qenë rrezik po të vazhdonte. Këto janë sfidat me të cilat përballemi për momentin, por çdo ekip duhet të përballlet me këto sfida gjatë sezonit", ka shtuar trajneri holandez. Për fillimin e pabesueshëm të sezonit, Slot ka deklaruar: "Askush, përfshirë edhe veten time, nuk e kishte parashikuar këtë. E dija që Kloppi e kishte lënë ekipin në një vend të mrekullueshëm. Megjithatë, të fitosh kaq shumë me të gjitha skuadrat e vështira me të cilat jemi përballur, nuk është diçka që mund ta parashikosh në fillim të sezonit".



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Faton Fejzullahu me nr. të protokollit 7118/23 të datës 05.12.2023 për parcelën kadastrale 00139-13, që ndodhet në Fshatin turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri" në Komunën e Prizrenit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e "Objektit për banim – turizëm fshatar" në Fshatin Turistik në Prevallë të Komunës së Prizrenit.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.11.12.2024 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Kushtet Ndërtimore të propozuara

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Tokë ndërtimore	
b. Vija rregulluese.	m'
c. Vija e ndërtimit.	1.0 m 3.0 m 9.80 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	h=10.15m' d=9.8m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	h=10.15 m' d=9.60m d=2.01 m d=1.00m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	20 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	80 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	20 %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	-
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Gurë, dru dhe tullë
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "EMARA group" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 812088608 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "EMARA group" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nr. 812088608 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "EMARA group" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 812088608 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Argjend Neziri nga Gjakova shpall të gjata dhe të shkurtra. Informata në pavlefshme diplomën e sh.m.t. tel: 049\44-888-801 (viber) "Nexhmedin Nixha.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. "Leonard Byci" B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin identifikues të Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut biznesit me nr. 811130195. Të lëshuar në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe nga ARBK. ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 qira , ne lagjen Dardania afër gusht (dy muaj), çmimi sipas Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi marrëveshjes. Për informata në tel. i Bardhe, banesa është e mobiluar 044/171-328. tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me - Lëshoj me qira banesën e mobiluar sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një te salloni i mobileve "ALBED" në dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: €uro. Banesa lëshohet për afate të 044/706-079.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “LTS KOSOVO” LLC, Graçanicë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin e Përpunimit të Profileve Metalike, në Konjuh, Lipjan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.01.2025 në ora 10:00 në objektin e Komunës së Lipjanit, Adresa; Rruga “Shqipëria”, Lipjan. do të organizohet debat publik nga Kompania “LTS KOSOVO” LLC, Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

https://eu-central-1.protection.sophos.com/?d=zoom.us&u=aHR0cHM6Ly91czA0d2ViLnnpvb20udXMvai80NTQ5MzQ0NDk1P3B3ZD1HYktjb2NjU1d4MzZlGM2U4UUY3UHNBa0NNM2J2SzYuMQ==&i=NjY1ZjJjOWVlZmMxZjE3Nzc3ZWVxNzcy&t=Mnh5R0tSSG1OT1M1Wk9BdGtOZUI4S3E1eTQ0MmsvNnZxZU5zSW5XSC9nMD0=&h=c53cf73b4eb54f0c96e8a636ffbfd24e&s=AVNPUEhUTONFTkNSWVBUSVaTRAueU-vNbNdW92a0FAisFOgf0Rln55_29at16bUHiQ

Meeting ID: 454 934 4495
Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “LTS KOSOVO” LLC, Graçanicë, për Impiantin e Përpunimit të Profileve Metalike, në Konjuh, Lipjan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin ynn.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cjejt Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

